

KARTA E-DYTE E APOSTOLLIT JOAN

1 ¹ Unë plaku mbë Zonjën' e-sgjedhurë, edhe mbë bijt' e asaj, të-cilëtë un' i dua me të-vërtetë; edhe jo vetëm' unë, po edhe gjith' ata që kanë njohurë të-vërtetënë; ² Për të-vërtetënë që mbetetë ndër ne, edhe dotë jetë bashkë me ne për gjithë jetënë; ³ Qoftë bashkë me ju hir, përdëllim, paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej Zotit Jisu Krishtit, Birit t'Atit, ndë të-vërtetë e ndë dashuri.

⁴ Ugëzuashë shumë, se gjeta **ca** nga bijt' e tu dyke ecurë ndë të-vërtetët, sikundrë muarmë porosi prej Atit. ⁵ Edhe tashi të lutem ty, o Zonjë, jo sikur se të shkruanj **ndonjë** porosi të-re, po atë që kishimë që ndë kryet, të duamë njëri tjetërinë. ⁶ Edhe këjo është dashuria, të ecëjmë pas porosivet t'ati. Këjo është porosia, sikundrë e dëgjuatë që ndë kryet, të ecëni mb'atë.

⁷ Sepse shumë kobimtarë hynë ndë botët, të-cilëtë nukë rrëfenjënë se Jisu Krishti erdhi ndë mish; i-tilli është kobimtarë edhe antikrishti. ⁸ Vështroni vetëhenë t'uaj, që të mos humbasëm ato që punuamë, po të marrëmë pagë të-plotë.

⁹ Kushdo që shkel **porosinë** edhe nukë mbetetë ndë mësimt të Krishtit, **ky** nukë ka Perëndi; ay që mbetetë ndë mësimt të Krishtit, ky ka edhe Atin' edhe Birinë. ¹⁰ Ndë qoftë se vjen ndonjë ndër ju, e nukë bje këtë mësim, mos e merrni ndë shtëpi, edhe mos i thoni ati, Gëzuash; ¹¹ Sepse ay që i thotë ati, Gëzuash, bënë të pjesëtar ndë punërat t'ati të-liga.

¹² Ndonëse pata shumë për të shkruarë juve, nukë desha me kartë e me mellan **t'u'a shkruanj**; po shprenj të vinj te ju, edhe të flas gojë për gojë, që të jetë i-plotë gëzimi ynë.

¹³ Të falenë me shëndet djemt' e s'at motëre së-sgjedhurë. (Amin.)